

LIGJ
Nr.10 363, datë 16.12.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Neni 25/2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25/2
Ambalazhet dhe materialet e barnave

Furnizimi i ambalazheve dhe i materialeve, që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 2

Neni 30 “Shkalla tatimore” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30
Shkalla tatimore

1. TVSH-ja zbatohet në masën 20 për qind, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

2. Furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i tatueshëm, me shkallën tatimore 10 për qind.”.

Neni 3
Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimeve për mallrat e importuara ose të blera para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që rezultojnë gjendje deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6836, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi